

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

INFORMATION AND
DATA PROTECTION
COMMISSIONER



**Privatësia e fëmijëve
dhe kujdesi prindëror**

TË MBROJMË PRIVATËSINË E FËMIJËVE !!!

Nëse studiojnë, bisedojnë, luajnë apo mësojnë diçka të re, ka gjasa që fëmijët tuaj janë duke shpenzuar kohën e tyre online. Si çdo prind, ju kaloni kohë duke menduar mbi mënyrat për t'u siguruar që fëmijët tuaj të bëjnë zgjedhjen e zgjuar dhe të sigurt kur përdorin internetin. Në mesin e shumë zgjedhjeve ata ballafaqohen në internet edhe me përhapjen e të dhënave të tyre personale.

Çfarë mund të bëni ?

Të dhënat personale të fëmijëve tuaj dhe privatësia e tyre janë të rëndësishme për ju dhe për vetë ata. Ja se si mund t'i mbronit të dhënat personale të fëmijëve tuaj, kur ata janë online.

Shikoni faqet e vizituara nga fëmijët tuaj.

Nëse një faqe interneti u kërkon përdoruesve të regjistrohen, kontrolloni se çfarë lloj informacioni kërkohet dhe nëse ju jeni të kënaqur me atë çka mund të përhapin fëmijët tuaj pikërisht në këto faqe. Nëse faqet e internetit i lejojnë fëmijët të vendosin informacion për veten e tyre, bisedoni me



fëmijën tuaj në lidhje me rreziqet dhe përfitimet që mund të shkaktojë dhënia e një informacioni të caktuar në internet.

Hidhini një sy politikës së privatësisë.

Vetëm për shkak se një faqe interneti ka një politikë privatësie nuk do të thotë se i mbron të dhënat personale. Politika e privatësisë duhet të tregojë se çfarë bën kjo faqe me informacionet që mbledh, dhe ju duhet të vendosni se si ndiheni në lidhje me këtë. Mos harroni, nëse politika e privatësisë thotë se nuk ka kufizime për të dhënat personale që mbledh ose cili i merr për t'i parë ato, kjo do të thotë se nuk ka fare kufizime.

Bëni pyetje

Nëse ju nuk jeni të qartë mbi praktikat apo politikat e privatësisë të një faqeje interneti, pyesni rreth tyre.

Të jeni selektiv me lejen tuaj.

Në shumë raste, faqet e internetit kërkojnë lejen tuaj para se ato të mbledhin informacion personal nga fëmijët tuaj. Faqet e internetit mund të kërkojnë lejen tuaj në disa mënyra, duke përfshirë edhe e-mailin. Gjithashtu, ju mund të jepni miratimin tuaj duke i lejuar ata të përdorin



kartën tuaj të kreditit. Përveç kësaj, kini parasysh kur jepni lejen tuaj, se ju mund të jepni pëlqimin për mbledhjen e disa të dhënave por jo të të gjithave.

Më shumë këshilla për prindërit

Flisni shpesh me fëmijët tuaj. Sigurohuni që fëmijët tuaj e dinë se çfarë informacioni duhet të jetë privat dhe çfarë informacioni mund të jetë i përshtatshëm për t'u dhënë sepse kur ata japin të dhënat e tyre personale, ata heqin dorë nga kontrolli mbi këto të dhëna.

Në varësi të asaj që ata bëjnë online, kujtojeni fëmijëve tuaj që sapo të vendosin të dhënat e tyre personale online, ata nuk mund t'i marrin ato përsëri mbrapsht. Edhe nëse ata i fshijnë këto të dhëna, ato mund të jenë ruajtur dhe mund të ekzistojnë në kompjuterët e njerëzve të tjerë dhe mund të shpërndahen sërish në internet.

Të dashur Prindër !

Përpiquni të mësoni se në çfarë faqesh lundrojnë fëmijët tuaj. Bisedoni me fëmijët për faqet që u pëlqejnë atyre të vizitojnë. Eksploronë vetë faqet e internetit që përdoren nga fëmijët tuaj dhe shihni politikat e privatësisë që ato ofrojnë.

Bëni një marrëveshje. Sigurohuni që fëmijët tuaj e dinë se çfarë u lejon familja për të publikuar në internet dhe çfarë jo. Merrni në konsideratë krijimin e një liste rregullash për të cilat familja juaj ka rënë dakord, dhe vendoseni atë në një vend ku mund t'a shohin të gjithë.

Lërinë fëmijët tuaj të dinë se ju jeni duke i vëzhguar në lidhje me faqet në të cilat ata lundrojnë. Një mundësi është që të kontrolloni historinë e shfletuesit tuaj dhe temporary files, ndonëse duhet të mbani mend se fëmijët më të mëdhenj mund të dinë se si t'i fshehin këto.

Mësoni se si fëmijët tuaj hyjnë online. Fëmijët mund të hyjnë në internet duke përdorur kompjuterin tuaj apo të dikujt tjetër, playstation, si dhe përmes telefonave celularë. Mësoni të vendosni limite edhe për këto pajisje të tjera, të cilat gjithashtu mund të lidhen me internetin.

Për më shumë informacion www.idp.al




**Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit
dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

Rr. e Kavajës, Nd 80, H.1, Tiranë

+355 4 22237200

info@idp.al; www.idp.al



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

INFORMATION AND
DATA PROTECTION
COMMISSIONER